



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

14330
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 15.07.2025

VENDIM

Nr. 239 datë 15/07/2025

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 “Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjit nr.75/2019 “Për rininë”; ligjit nr.69/2012; ligjit nr.9270 date 29.07.2004; ligjit nr.9632, date 30.10.2006; Udhëzimi nr. 30/2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.188, datë 29.05.2025, i ndryshuar.
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka, me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër;
 - Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ për:
 - Drejtorinë e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë
 - Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
 - Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe.
 - Drejtorinë e Përgjithshme Kulturës dhe Sportit
 - Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore
 - Drejtorinë e Arsimit
 - Gjendjen Civile
 - Konfirmimin e adresave të qytetareve
3. Zv/Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 15.07.2025 dhe përfundojnë me datë 25.07.2025, ora 16.00.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

Benet BECI

